



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Punës së Qeverisë për vitin 2020 dhe Plani Indikativ i Punës së Qeverisë për vitet 2021 dhe 2022.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ për vitin 2020 t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Plani i Punës së Qeverisë mund të plotësohet/ndryshohet në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, neni 48, pika 5 si dhe shkresën e Kryeministrit Nr. 014/2020 të datës 05.06.2020.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2021.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij Plani ta harmonizojë me Ligjin për Buxhetin e vitit 2021.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për kufijtë e dozave dhe mbrojtjen nga rrezatimi.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me nr. 215/20, datë 09.06.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Në lidhje me vendimet e Qeverisë që kanë mbetur në procedurat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës deklarohet si në vijim:
 - 1.1. Të procedohen tutje për shqyrtim në procedurat e Kuvendit:
 - Raporti i Statistikave Zyrtare për vitin 2019 dhe
 - Raporti Tremujor Financiar për vitin 2020.
 - 1.2. Tërhiqen nga procedurat e Kuvendit:
 - Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L- 091 dhe
 - Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2020-2024.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë vendim t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4), si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitetse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë

1. Plotësohet dhe ndryshohet pika 5. e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/38, të datës 31 maj 2020, si në vijim:
 - 1.1. Përveç pikave kufitare të përcaktuara në pikën 5. të Vendimit të Qeverisë Nr. 02/38, të datës 31 maj 2020 (Merdarë, Vermicë, Kullë, Hani i Elezit, Jarinjë dhe Dheu i Bardhë), hapen kufijtë tokësor në Republikën e Kosovës edhe për këto pika:
 - Pika e Kalimit të Kufirit Qafë Prush;
 - Pika e Kalimit të kufiri Qafë Morinë;
 - Pika e Kalimit të Kufirit Muqibabë;
 - Pika e Kalimit të Kufirit Mutivodë;
2. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, do të analizojë situatën që varësisht nga kapacitetet gradualisht të hapë edhe pikat tjera kufitare;
3. Obligohen institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi konform vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
4. Vendimi hyn në fuqi nga data 22.06.2020.

A r s y e t i m

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet situatë e qëndrueshme me rritje të lehtë të rasteve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Botërore, e përfaqësuar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, për financimin e "Projekti emergjent COVID-19 për Kosovën".
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për miratimin e "Protokollit numër 7 për Zgjidhjen e mosmarrëveshjes brenda CEFTA-s".
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të zhvillojë negociatat në kuadër të Marrëveshjes për ndryshimin dhe Aderimin në Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufirit.
2. Autorizohet Ministria e Punëve të Brendshme të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë